

VENDIM
Nr.34, datë 14.12.2011

PËR LICENCIM PËR HERË TË PARË
“NDËRMARRJA UJËSJELLËS, MALËSIA E MADHE” SHA

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë.....” Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të licencohet për herë të parë “Ndërmarrja Ujësjiellës Malësia e Madhe” sh.a. operatori me:
 - Drejtues ligjor, z. Hajrullah Shaqir Gjekaj.
 - Drejtues teknik, z. Sejdi Ali Curri.
2. Operatori “Ndërmarrja Ujësjiellës Malësia e Madhe” sh.a. autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
3. Zona e shërbimit e këtij operatori është: bashkia Koplik, komunat Gruemir, Shkrel, Koplik Qendër, Kastrat, Kelmend.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri më datë 14.12.2015.

KRYETARI
Avni Dervishi